



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 31/11

Prishtinë, më 19.10.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj dhe Hasime Krasniqi.

Mungoi: Duda Balje

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ymer Havolli dhe Adrian Zalli-TKPK, Rrahman Paçarizi dhe Sylejman Shaqiri-RTK, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami dhe Juergen Schatz-GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtur më datë 11.10.2011;**
- 3. Shqyrtimi i propozimit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për Uljen e Taksës Menaxhuese,**
I ftuar: Ymer Havolli, Ushtrues Detyre i Kryesuesit të Bordit Udhëheqës të TKPK-së;
- 4. Shqyrtimi i projeksioneve të buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën Tetor– Dhjetor 2011,**
I ftuar: Rrahman Paçarizi, Kryetar i Bordit të RTK-së;
- 5. Shqyrtimi i Raporti të Komisionit për Legjislacion, Raportit të Komisionit për Integritet Evropian dhe Amendamentit të propozuar nga Kryetarët e Grupeve Parlamentare lidhur me Projektligjin nr.04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/174 për financimin e subjekteve politike;**

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-047 për Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-71 për Sistemin e Adresave, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së;
8. Shqyrtimi i rekomandimit të Nënkomisionit për Mandate dhe Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës lidhur me përshkrimin e fushëveprimit dhe përgjegjësi të Komisionit;
9. Diskutim lidhur me përmbledhjen ligjore të Agjencioneve dhe Institucioneve pavarura;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më datën 11.10.2011

Procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për Uljen e Taksës Menaxhuese

Kryetarja, theksoi që sipas Ligjit, Bordi i TKPK-së është i obliguar që t’ia paraqes Kuvendit kërkesën për taksën menaxhuese, të cilën e cakton Kuvendi dhe sipas së cilës bëhet edhe planifikimi i buxhetit të TKPK-së. TKPK-ja kërkon uljen e taksës menaxhuese për 0.05 %, pra nga 0.65 % sa është aktualisht të ulët në 0.60%. Gjithashtu në materialin e sjellur nga TKPK-ja, paraqitet edhe një planifikim i buxhetit, i cili tregon një shtesë në krahasim me vitin e kaluar prej 12.000 € dhe ka lëvizje në pozicionet e caktuara të planifikimit.

Ymer Havolli, theksoi se është paraparë që gjatë vitit 2012 Trusti do të ketë në menaxhim një projektion prej 621 milion € varësisht prej performancës në tregun financiar dhe aftësisë për të grumbulluar mjete në tregun e brendshëm. Duke e ngarkuar taksën menaxhuese vjetore me 0.60 % mbi fondin pensional TKPK-ja në vitin 2012 parasheh të sigurojë të hyra prej 3.73 milion €, përderisa buxheti i aprovuar për vitin është rreth 3.89 milion € dhe në tërësi buxheti për vitin 2012 ka një lëvizje prej 12.000 € ose 0.03 % në krahasim me vitin 2011. Aktualisht në Trust janë duke u bërë disa renovime në teknologjinë informative në mënyrë që në të ardhmen të merret parasysh faktori demografik në procesin e investimeve.

Hasime Krasniqi, mbështeti kërkesën e Bordit të TKPK-së për uljen e taksës menaxhuese dhe pyeti për rritjen e buxhetit prej 0.03 % për vitin 2012, se a është shkaku i zhvillimit dhe kompletimit të softuerit të ri apo qëndron ndonjë arsye tjetër?

Ymer Havolli, sqaroi se softueri ka qenë një donacion, i cili tani është duke u implementuar, ndërsa rritja prej 0.03 % është shkaku i kërkesës së BQK-së për hapjen e dy vendeve të punës dhe atë të auditorit të brendshëm dhe kontabilistit. Natyrisht që ka të bëjë edhe numrin e kontribuesve që

parashihet të rritet relativisht për vitin 2012, mbi 20.000 kontribuues, të cilët kanë kosto shtesë si dërgesa e pasqyrave dhe komunikimi.

Kryetarja, përmendi çështjen e pagave dhe nuk ndikon mirë kjo kur shihet se ka rritje të pagave të punonjësve, mirëpo vërehet një rritje e madhe edhe te qiraja dhe pyeti për shkakun e kësaj rritjeje.

Adrian Zalli, TKPK-ja është në një zyre në qendër të Prishtinës, për të cilën paguan rreth 3.900 € për 800 metra katror. Kur do të skadojë kontrata me qiramarrësin do të jetë shumë e vështirë që të gjejmë një vend tjetër me këtë çmim të volitshëm dhe për këtë arsye kemi projektuar më shumë deri sa të gjendet një vend të përshtatshëm.

Xhevdet Neziraj, pyeti që subjekti politik i ka bërë disa pagesa të pagave nëpërmes thesarit dhe një numri të madh nuk u kanë ardhur pasqyrat, edhe pse kanë shkuar nëpërmjet thesarit dhe administratës tatimore, ku qëndron arsyeja?

Adrian Zalli, sqaroi që problemi më i madh me fondet e pa alokuara ka të bëjë me subjektet politike, si dhe KQZ-ja e cila punëson njerëz për një kohë të shkurtër, i paguan tatimet, mirëpo nuk i dërgon listat për të parë se kujt i takojnë këto kontribute pensionale. Është një moskuptim i tyre, sepse mjetet janë në Trust, mirëpo nuk dihet emri i kontribuesve. Kjo nuk është çështje e Trustit, as e ATK-së, por është çështje e kontabilistit të subjektit politik përkatës.

Kryetarja, theksoi që Komisioni asnjëherë nuk ka pasur informata lidhur me sistemin e pagesave si dhe nuk ka shënime lidhur me rrjedhën e shpenzimeve të buxhetit për periudhën deri sa është bërë kërkesa. Nëse shkohet në këtë mënyrë pa informata të nevojshme dhe pa arsyetime, atëherë mund të jetë një hendikep në punën e mëtutjeshme.

Ymer Havolli, sqaroi që Kuvendit i është dërguar një raport financiar për vitin 2010, i cili është aprovuar nga Kuvendi dhe në të cilin janë pasqyruar të gjitha të dhënat operative të investimeve. Gjithashtu i dorëzojmë çdo tre mujor raportin për të përcjellur rrjedhën dhe performancën e investimeve dhe shpenzimeve në TKPK. Lidhur me pagat sqaroi se ky Bord kur e ka marrë detyrën e ka bërë zvogëlimin e pagave të menaxhmentit duke e marrë për bazë teknologjinë bankare në Kosovë. Në degën në të cilën punojmë nevojitet një ekspertizë më specifike dhe asnjëri nga menaxhmenti i TKPK-së nuk ka të ardhura më të mëdha se sa ato që janë të deklaruara.

Muhamet Mustafa, përkrahu propozimin për uljen e taksës menaxhuese, duke pasur parasysh që ky është një fond shumë i rëndësishëm dhe ekziston mundësia që me rritjen e kontributeve kjo taksë të zbritet edhe deri në 0,5%. Sa i përket çështjes së pagave duhet të zgjidhet njëherë e përgjithmonë dhe do të kishte qenë mirë që Bordi ta trajtojë këtë çështje dhe të përgatisë një raport duke arsyetuar pozicionet e veta dhe të njoftojë anëtarët e komisionit për politikën e pagave, në mënyrë që të qartësohen më mirë gjërat dhe të aprovohen. Lidhur me qiranë nuk ekziston ndonjë problem dhe mund të zgjidhet më lehtë, mirëpo Bordi duhet të ketë një politikë restriktive të matur të shpenzimeve duke pasur parasysh që operon me mjetet e një kategorie të ndjeshme.

Sali Asllanaj, përkrahu uljen e taksës menaxhuese, mirëpo çështja e pagave sot nuk është në rend të ditës dhe për këtë temë kemi marrë sqarime të përpikta nga Bordi në mbledhjen kur është shqyrtuar raporti vjetor financiar. Duhet pasur parasysh që tregu operativ është evropian, prandaj edhe të ardhurat janë duhet të jenë përafërsisht evropiane. Më e rëndësishme është që të dihet performanca e atyre mjeteve se si po plasohen dhe suksesi i tyre.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese nga 0.65% në 0.60%, dhe e njëjta të zbatohet nga 1 Janari i vitit 2012.

4. Shqyrtimi i projeksioneve të buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën Tetor–Dhjetor 2011

Kryetarja, bëri vërejtje për sjelljen me vonesë të kërkesës lidhur me projeksionet buxhetore për periudhën Tetor-Dhjetor 2011, pasi që kërkesa për këtë tremujor është dashur të miratohet në Shtator dhe të fillohet nga 1 Tetori për tre mujorin e fundit.

Rrahman Paçarizi, sqaroi se arsyeja e vonesës së kërkesës është përgatitja e raportit financiar për periudhën Janar-Shtator, i cili është përgatitur pas përfundimit të muajit Shtator. Lidhur me projeksionet buxhetore nuk ka ndonjë kreativitet, pasi që buxheti është i përcaktuar për tërë vitin dhe pothuajse është i njëjtë me tremujorët e mëparshëm.

Muhamet Mustafa, theksoi që ka pak probleme lidhur me këto projeksione pasi që shpenzimet që janë bërë për nëntë muaj kanë qenë të parapara për dymbëdhjetë muaj. Duhet të ketë sqarime nga Bordi se si do të mbulohen këto shpenzime, pasi që dalja në humbje e një transmetuesi publik mund të jetë problem.

Sylejman Shaqiri, theksoi që patjetër do të jenë të detyruar të bëjnë kërkesë për mjete shtesë, pasi që kemi hyrë me një plan buxhetor, i cili ka qenë së paku i nivelit të kaluar të mjeteve buxhetore.

Sali Asllanaj, pyeti nëse ka procedurë ligjore me të cilën mund të aprovohet kërkesa për mjete shtesë, pasi që është keq të rezultojë me bilanc negativ.

Kryetarja, theksoi që nuk janë të paraqitura edhe të hyrat që i ka realizuar RTK-ja, pasi që nuk mund të jetë tërë kjo diferencë në raportin financiar nëse është realizuar diçka nga të hyrat vetanake. RTK-ja e din si janë mundësitë buxhetore dhe nuk mund të bëjë në çdo moment kërkesë dhe është dashur që t'i ngushtojë kërkesat e veta dhe mos të hyjë në borxhe.

Sylejman Shaqiri, sqaroi që të hyrat prej 1.125.000 € kanë qenë të planifikuara, të cilat janë tejkaluar për 51.000 €, që do të thotë se për periudhën Janar-Shtator janë realizuar 1.176.000 €.

Rrahman Paçarizi, sqaroi që borxhi kryesor ka qenë në ndryshimin ndërmjet tre mujorit të parë që janë marrë rreth 2.600.000 € për këstin e parë, ndërsa sipas shpërndarjes së rregullt të këtij buxheti aktual do të duhej të ishin 1.700.000 €, që i bjen diku rreth 900.000 € janë marrë më shumë dhe janë shpenzuar dhe në tre mujorin e dytë kemi hyrë me borxhe. Gjithashtu edhe hyrja në fuqi e Ligjit të Punës ka kushtuar rreth 224.000 € brenda një tre mujori për shujtat ditore, për shpenzime të sigurimit dhe shpenzime tjera shtesë. Jemi përpjekur të funksionojmë brenda kufirit të mjeteve buxhetore duke i bërë zvogëlimin e disa shpenzimeve, por prapëseprapë ka qenë e pamundur që të sigurohet program me këto mjete.

Hykmete Bajrami, theksoi që nëse aprovohen projeksionet buxhetore të RTK-së për periudhën Tetor-Dhjetor, atëherë kjo i bjen që komisioni do të aprovojë edhe buxhetin shtesë dhe po lejojmë që

të hyjnë në deficit dhe pastaj do të jemi të detyruar që këtë deficit ta mbulojmë me buxhetin e vitit 2012.

Albana Fetoshi, pyeti se sa është vlera e mjeteve shtesë që parashihen si obligime?

Sylejman Shaqiri, sqaroi që kërkesa ka të bëjë vetëm me këstin e fundit në kuadër të buxhetit që është miratuar prej 7.900.000 € dhe nuk është kërkesë për mjete shtesë. Lidhur me obligimet u përgjigj se nuk është e gatshme kjo vlerë, sepse duhet të konkretizohet pasi që ka edhe disa obligime për shkak të natyrës së punës.

Albana Fetoshi, propozoi që nëse kjo mund të kryhet në një periudhë të shkurtër, atëherë mos të aprovohen tash projeksionet dhe të sjellin një shkresë me këto sqarime në një mbledhje tjetër.

Sylejman Shaqiri, theksoi që nuk është në rregull të mos miratohet tash një kështu, i cili është miratuar në fillim të vitit.

Xhevdet Neziraj, theksoi që RTK-ja po kërkon këstin e fundit prej 1.761.000 €, i cili është miratuar nga komisioni dhe tani duhet të realizohet, ndërsa për obligimet tjera mbetet të shihet kur të miratohet buxheti për vitin 2012.

Muhamet Mustafa, theksoi që problemi qëndron në faktin se RTK-ja do të ketë shpenzime më të mëdha se sa që është aprovuar.

Pas diskutimeve, Komisioni me nëntë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), asnjë kundër dhe një abstenim (Hykmete Bajrami), nxorri këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Administratës së Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr. 1110101219060187, në shumën prej 1,761.333 Euro, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2011.
5. **Shqyrtimi i Raporti të Komisionit për Legjislacion, Raportit të Komisionit për Integritet Evropian dhe Amendamentit të propozuar nga Kryetarët e Grupeve Parlamentare lidhur me Projektligjin nr.04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/174 për financimin e subjekteve politike**

Kryetarja, sqaroi që amendamenti 7 që i referohet nenit 11 të ligjit në fuqi është refuzuar nga Komisioni për Legjislacion, i cili ka të bëjë me çështjen e donacioneve.

Naser Osmani, theksoi që çështja për të cilin është deklaruar Komisioni për Legjislacion është pak konfuze, meqenëse ne kemi kërkuar një interpretim juridik nga Sekretariati lidhur me të drejtën tonë për të ndërhyrë në ligje dhe kemi marrë përgjigje pozitive. Komisioni për Legjislacion është thirrë në nenin 65.1 të Kushtetutës së Kosovës dhe jo në nenet e Rregullores së Kuvendit të Mirëpo, për derisa deputetët e Kuvendit me shumicë votash e votojnë një gjë të tillë, atëherë kjo nuk është në kundërshtim. Raporti i Komisionit për Legjislacion nuk është shumë i konsultuar dhe i bazuar dhe duhet të insistohet që ligji mos të kthehet në Qeveri.

Muhamet Mustafa, përkrahu mendimin e parafolësit dhe se raporti i Komisionit për Legjislacion nuk ka arsye. Propozoi që në Kuvend të shkohet me qëndrimin që është marrë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kryetarja, sqaroi që është edhe një rekomandim për nenin 11 të ligjit nga Komisioni për Integritet Evropian, të cilët kërkojnë që pas amendamentit që është propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të shtohet pika 1.4 si në vijim: “Subjektet juridike të cilat përfitojnë kontrata apo tenderë publikë nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga ndërmarrjet publike” do të thotë që ndalohej edhe kjo.

Xhevdet Neziraj, theksoi që kjo çështje rregullohet me një nen tjetër që parasheh se ndërmarrjet publike nuk kanë të drejtë të financojnë subjektet politike dhe mos të dyfishohet.

Muhamet Mustafa, konsideroi që propozimi i Komisionit për Integritet Evropian, nuk lejon dhënien e donacioneve subjektet që kanë fituar tender. Ky është një problem i caktuar, pasi që kemi vendosur që kjo të jetë transparente duke u shënuar firma në raport.

Naser Osmani, theksoi që me këtë amendament përjashtohet një kategori e ndërmarrjeve private që mund të jenë donatorë potencialë të partive politike.

Kryetarja, theksoi që mënyrë se si është formuluar amendamenti nga Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka zgjidhur problemin e donacioneve dhe nuk është mirë që të bëhen shumë ndalesa, sepse ligji mund të mos zbatohet atëherë.

Sali Asllanaj, përkrahu propozimin e Komisionit për Integritet Evropian, i cili ju jepe mundësi partive politike që të funksionojnë me financim publik dhe më pak të varen nga mjetet e donatorëve, sepse rrallë herë ka donatorë të vërtetë, më tepër ka përfitues të cilët ndajnë mjete për parti politike.

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit për një amendament për nenin 7, paragrafi 3 nga shënimet e grupeve parlamentare, që kanë kërkuar që të shtohet shuma e mjeteve buxhetore dedikuar fondit për mbështetje të subjekteve politike nga 0,17% sa ka qenë në fillim në 0,34% të buxhetit të Kosovës.

Latif Gashi, përkrahu propozimin e shënimet të grupeve parlamentare dhe konsideroi që komisioni duhet ta aprovojë.

Muhamet Mustafa, konsideroi që kjo mënyrë e punës nuk është korrekte, për shkak se shënimet e grupeve parlamentare duhet të japin një arsye se prej cilave zëra do të merren mjetet që janë përafërsisht 4.000.000 €.

Kryetarja, sqaroi arsyetimin i cili bazohet në atë se buxheti më i madh mundëson që të ketë stabilitet financiar të subjekteve politike dhe transparencë më të madhe.

Komisioni njëzëri nuk e përkrahu raportin e Komisionit për Legjislacion lidhur me Projektligjin nr.04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/174 për financimin e subjekteve politike.

Komisioni me një votë për (Sali Asllanaj), gjashtë vota kundër (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi dhe Xhevdet Neziraj) dhe tri abstenime (Hykmete Bajrami, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa), nuk e përkrahu raportin e Komisionit për Integritet

Evropiane lidhur me Projektligjin nr.04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/174 për financimin e subjekteve politike.

Komisioni me nëntë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Hykmete Bajrami), një kundër (Muhamet Mustafa) dhe asnjë abstenim, përkrahu amendamentin e propozuar nga Kryetarët e Grupeve Parlamentare lidhur me Projektligjin nr.04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/174 për financimin e subjekteve politike.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe i njëjti riprocedohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-047 për Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Komisioni me nëntë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), asnjë kundër dhe një abstenim (Albana Fetoshi) nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-71 për Sistemin e Adresave, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Kryetarja, sqaroi që raporti me rekomandime i komisionit funksional nuk përmban implikime buxhetore, mirëpo në deklaratën financiare që ka ardhur nga Ministria e Financave shihet që ka implikime buxhetore, pasi që shkruhet se do të punësohen 43 të punësuar. Është një projektligj që ka të bëjë me Ministrinë e Ambientit dhe më Agjencionin për Kadastra, të cilët kanë dorëzuar një deklaratë në të cilën thuhet se është reduktuar kjo çështje, mirëpo Komisioni duhet t'i bëjë dy ndërhyrje në projektligj, në mënyrë që mos të ketë implikime buxhetore. Këtu është fjala për komunat, ku parashihen 38 të punësuar, mirëpo në secilën komunë janë të formuara Zyret Kadastrale dhe është një projekt që ka të bëjë me sistemin e adresave, i cili financohet nga Komisioni Evropian diku 3.000.000 € dhe një pjesë tjetër financohet nga Banka Botërore dhe Qeveria Norvegjeze. Rekomandimi është që ky sistem i adresave është shumë i domosdoshëm për të qenë Kosova pjesë e liberalizmit të vizave.

Hykmete Bajrami, theksoi që është e nevojshme të bisedohet me komuna për të parë se a kanë kapacitete stafi i tyre, pasi që kjo ka të bëjë me liberalizimin e vizave. Pyeti se a është e aprovuar që Banka Botërore dhe Qeveria Norvegjeze do t'i bartin këto shpenzime.

Kryetarja, sqaroi se në bazë të informatave nga Agjencioni Kadastral komunat kanë kapacitete, por duhet perfeksionimi në kryerjen e kësaj pune, përgjegjësinë për të cilën e merr Komisioni Evropian.

Komisioni më tetë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), asnjë kundër dhe dy abstenime (Albana Fetoshi dhe Hykmete Bajrami), nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji nr.04/L-71 për sistemin e adresave, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 24 paragrafi 2 dhe neni 25 paragrafi 2, dhe vendosi që ti propozojë këto amendamente:

Amendamenti 1

Neni 24, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

”Të gjitha elementet e adresës në Komunë regjistrohen dhe mirëmbahen nga stafi ekzistues i drejtorisë përgjegjëse në regjistrat komunale të adresave në pajtim me dispozitat e këtij ligji”.

Amendamenti 2

Neni 25, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

”Ministria siguron koordinim ndërmjet institucioneve qeveritare dhe komunale dhe siguron mundësi teknike dhe financiare për zbatimin uniform të sistemit të adresave”.

2. Amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i rekomandimit të Nënkomisionit për Mandate dhe Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës lidhur me përshkrimin e fushëveprimit dhe përgjegjësi të Komisionit

Kryetarja, lidhur me fushëveprimtarinë e komisionit, theksoi që duhet të zëvendësohet termi “Ministria e Ekonomisë dhe Financave” me “Ministria e Financave”.

Hykmete Bajrami, propozoi këtë përpilim që ka të bëjë më tepër me përshkrimin e fushëveprimtarisë së komisioneve tjera: “Komisioni ka për detyrë analizimin e buxhetit në detaje për sektorin që komisioni është përgjegjës dhe dhënie me shkrim të vërejtjeve dhe sugjerimeve Komisionit për Buxhet dhe Financa, vërejtje këto që komisioni mund t’i ketë rreth shpërndarjes së buxhetit në sektorin përkatës.”

Naser Osmani, riformuloi propozimin e parafolësës: “Komisioni për Buxhet dhe Financa koordinon punën me komisionet funksionale lidhur me buxhetet sektoriale.”, edhe pse kjo në praktikë rrallë herë ka ndodhur, mirëpo nëse është e shkruar do të jetë më mirë.

Kryetarja, propozoi që propozimi i parë i deputetit Muhamet të riformulohet si në vijim: “Përcjell dhe analizon stabilitetin makroekonomik - fiskal dhe jep rekomandime për Kuvendin” dhe të vendoset si vazhdim i pikës së dytë në fushëveprimtarinë e komisionit, do të thotë pas “çështjet buxhetore dhe financiare”.

Komisioni njëzëri miratoi propozimin e riformuluar.

Kryetarja, lidhur me propozimin e dytë të deputetit Mustafa theksoi se kjo nuk është një çështje që i takon Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Muhamet Mustafa, theksoi që përcjellja e bashkëpunimit të Kosovës me institucionet financiare ndërkombëtare është çështje që lidhet direkt me stabilitetin e vendit.

Komisioni me gjashtë vota për (Muhamet Mustafa, Naser Osmani, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Albana Fetoshi), dy kundër (Safete Hadërgjonaj dhe Jelena Bontić) dhe asnjë abstenim miratoi propozimin e dytë të deputetit Muhamet Mustafa.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Nënkomisionit për Mandate dhe Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës, të përfshijë fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në Rregulloren e re të Kuvendit.

9. Diskutim lidhur me përmbledhjen ligjore të Agjencioneve dhe Institucioneve pavarura

Kryetarja, njoftoi që stafi është përpjekur që të bëjë një përmbledhje të asaj se çka parashohin ligjet lidhur me agjencionet e pavarura dhe si është çështja e raportimit të tyre në Kuvend, pasi që është afruar koha e ardhjes së buxhetit në Kuvend dhe shumë çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e përcaktimit të buxhetit të këtyre agjencioneve nuk është e paraparë në ligj.

Sali Asllanaj, theksoi që materiali të shfrytëzohet për të gjetur një zgjidhje me të cilën do të formonim një kornizë ligjore për të gjitha agjencionet, pasi që është një laramani ligjore por edhe në mënyrën e pagesave të stafit dhe të bordeve.

Hykmete Bajrami, përkrahu propozimin e parafolësit, por është e pamundshme, për shkak se secili institucion kushtetues e ka edhe ligjin për themelimin e tyre dhe nëse bëhet një kornizë ligjore, atëherë duhet që të ndërhyjmë në të gjitha këto ligje. Ajo çka mund të bëjmë është harmonizimi i pagave të këtyre agjencioneve.

Xhevdet Neziraj, propozoi që këto agjencione të klasifikohen në tri forma dhe agjencionet kushtetuese të kenë trajtim të barabartë. Në këtë mënyrë do të kishim pasur një pasqyrë më reale për pagat, por edhe për çështjet tjera.

Kryetarja, propozoi që t'u dërgohet nga një shkresë të gjitha agjencioneve të pavarura, për të dhënë informata më të detalizuara rreth mënyrës së shpenzimit të buxhetit për nëntë mujorin e parë, pasi që është edhe koha kur pritet që të vie buxheti në Kuvend.

Muhamet Mustafa, përkrahu këtë iniciativë, por kërkoi edhe ndihmën e GIZ-it për të bërë një raport përmbledhës dhe krahasues të këtyre agjencioneve.

Naser Osmani, propozoi që të mbahet një workshop për të bërë klasifikimin e agjencioneve nëpër kategori sipas përgjegjësi që i kanë.

Muhamet Mustafa, kërkoi që para se të mbahet takimi të kenë një analizë për të parë se si janë këto agjencione nëpër vende tjera.

Pas diskutimeve, Komisioni nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni do të organizojë një workshop, ku do të diskutohen për buxhetin e agjencioneve të pavarura.

10. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi për ftesën që ua ka bërë Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa për t'iu bashkangjitur grupit punues për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Komisioni njëzëri caktoi këta dy anëtarë:

1. Muhamet Mustafa
2. Latif Gashi

Mbledhja përfundoi në orën 13:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona